



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 902 Prot.

Tiranë, më 14/06 /2021

**Lënda:** Komente dhe sugjerime mbi Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021 - 2025).

**Drejtuar:** **MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

Në vijim të takimit të Grupit Tematik për Përfshirjen dhe Mbrojtjen Sociale dhe Grupit Tematik për Punësimin dhe Aftësitë, në kuadër të GMIP për Punësimin dhe Sektorin Social, ku u prezantua Draft-Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ju parashtron disa komente dhe sugjerime si më poshtë:

#### ❖ Vlerësime të përgjithshme

Së pari, do të nevojitej një vlerësim mbi arritjet dhe sfidat mbi Planin e mëparshëm Kombëtar për Romët dhe Egjiptianët 2016-2020, i cili do të shërbente caktimit të duhur të Objektivave dhe Qëllimeve Politike në këtë Draft-Plan të ri.

Me qëllim nxitjen e zbatimit të këtij PKVBPPRE 2021-2025, rekomandojmë që vlerësimi dhe monitorimi i zbatimit të masave të bëhet në mënyrë periodike, për periudhë 1-vjeçare.

Lidhur me terminologjinë e përdorur në këtë PKVBPPRE 2021-2025 për "*Pakicat rome dhe egjiptiane*", ky plan herë i referohet si minoritet e herë si komunitet. Duke qenë se në Ligjin "*Për Pakicat Kombëtare në RSH*", përdoret termi "pakicë", propozojmë të ketë një unifikim të termit "komunitet" dhe/ose "minoritet" në termin "*Pakicë*".

Ajo që evidentohet në Draft- Planin e Veprimit 2021-2025 është mungesa e parashikimit, në disa aktivitete, të Institucioneve Përgjegjëse. Një element i rëndësishëm i Planit Kombëtar të Veprimit 2021-2025 duhet të jetë edhe parashikimi i burimit financiar dhe kostove për të siguruar realizimin e objektivave të përcaktuara.

Lidhur me kuadrin ligjor dhe institucional të përfshirë në hyrje të Draftit të PKV-së, duhet specifikuar se Ligji 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është i ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020. Gjithashtu edhe Ligji “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” është i ndryshuar me Ligjin Nr. 51/2013.

Gjithashtu, termi “*Diskriminimi i Hapur ose i Fshehur*”, i përdorur në Draft Plan, do të ishte e përshtatshme të zëvendësohej me termin “*diskriminim i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë*”, duke e përshtatur me legjislacionin anti-diskriminim.

Në pjesën narrative është përdorur termi “*persona të paaftë*”, dhe duhet të zëvendësohet me termin “*Persona me aftësi të kufizuar*”.

Në faqen 14 të Draft-Planit duhet të behet një saktësim në paragrafin e mëposhtëm: “*Mekanizmat institucional për të njohur dhe sanksionuar gjuhën e urrejtjes mbeten kryesisht joefektive. Bazuar në raportin vjetor të Komisionerit kundër diskriminimit, ka pasur 43 raste për periudhën 2017-2018 të diskriminimit për shkak të racës. Minoriteti Rom dhe Egjiptian nuk është i informuar mirë për të drejtat, shërbimet ose rrugët ligjore për të ofruar këto shërbime*”. Paragrafi i mësipërm duhet riformuluar si më poshtë, pasi nuk është shumë i saktë: “*Me ndryshimet e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, gjuha e urrejtjes është e përfshirë si formë më vete e diskriminimit. Gjithashtu, pavaresisht faktit nëse në Ligj, nuk ka qene e parashikuar gjuha e urrejtjes, Komisioneri ka trajtuar vazhdimisht raste të çështjeve që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes, të nisura kryesisht. Bazuar në Raportin Vjetor të vitit 2018 të Komisionerit, në 43 raste është pretenduar diskriminim për shkak të racës*”

Në faqen 37 të Draft Panit është bërë një konstatim, si më poshtë, i cili nuk tregon burimin e informacionit: “*Ndërsa në të kaluarën, vendimet e KMD-së shpesh rrëzoheshin nga gjyqësori, kjo prirje duket se është ndalur dhe përmbysur*”, në rast se ka një burim ku është marr ky informacion duhet të pasqyrohet.

Struktura e Planit të Veprimit, ka përcaktuar gjashtë fusha, por vlerësojmë nisur nga situata, që çështje të veçanta kërkojnë prioritet dhe zgjidhje të menjëhershme duke mbajtur parasysh që Plani shtrihet në harkun kohor 2021-2025.

**Vlerësojmë se Plani duhet të parashikojë disa aktivitete si çështje parësore, të cilat referuar Rekomandimeve të Raportit të ECRIT, për Shqipërinë, për vitin 2020, duhet të jenë:**

- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore të domosdoshme (legjislacioni dytësor) Për Ligjin “Për Ndihmën Juridike”.
- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore të domosdoshme (legjislacioni dytësor) Për Ligjin “Për Strehimin Social”.

- Zgjidhje e shpejtë për krizat afatgjata të strehimit që prekin komunitetet romë dhe egjiptiane në zonat e Kabashit dhe të Gurit të Kuq të Bashkisë Pogradec.

**Gjithashtu një çështje që kërkon prioritet, sipas vlerësimit të KMD-së është:**

- **Miratimi i VKM-së “Për Hartimin e kriterëve dhe procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre”**

**Të gjitha këto aktivitete prioritare duhet të parashikojnë afatin e realizimit, sikurse ka rekomanduar ECRI në Raportin e tij (brenda vitit 2022), treguesit, institucionet përgjegjëse dhe kostot.**

- ❖ **Mbi fushat dhe objektivat e përcaktuara në këtë Draft-Plan, po ju përcjellim edhe disa sugjerime mbi gjendjen aktuale, kryesisht nga evidentimet që kanë dalë gjatë punës së Komisionerit:**

- **Regjistrimi civil dhe aksesit në drejtësi**

Ligji nr. 111/2017 “ *Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti* ” ka parashikuar rregullat dhe procedurën për ofrimin e ndihmës juridike detyësore nga avokatët e përfshirë në listën që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike detyësore. Një nga problemet e evidentuara shpesh me përcaktimin e avokatëve, në bazë të ligjit të mëparshëm, ka qenë profesionalizmi dhe cilësia e mbrojtjes. Këto çështje mbeten sërish të parregulluara plotësisht në ligjin nr. 111/2017 dhe ligji e delegon këtë rregullim pjesërisht te aktet nënligjore, për çështje si rotacioni i avokatëve, hartimi i listave, për zgjedhja, tarifat e avokatëve etj. Aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 111/2017 “*Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti*” janë miratuar në tejkallim të afateve ligjore (10 akte). Dy prej tyre, të cilat nuk janë miratuar ende, janë përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.

- **Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor**

Problematika e regjistrimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në kopshtet publike në qytetin e Tiranës. Komisioneri ka konstatuar se praktika e ndjekur nga Bashkia e Tiranës duke dështuar për të trajtuar fëmijët e këtyre pakicave si grupe në nevojë dhe për t’i përjashtuar nga tarifa e regjistrimit në kopshte, diskriminonte në mënyrë të tërthortë këta fëmijë për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Bazuar në rekomandimin e Komisionerit, Bashkia Tiranë mori masa për përfshirjen e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit Rom/Egjiptian, si kategori, që përfiton shërbim pa pagesë në Kopshtet dhe Çerdhet publike të Tiranës.

Problematika e braktisjes së shkollës nga fëmijët romë për shkak të varfërisë është një tjetër konstatim nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në këtë mënyrë këta fëmijë përfundojnë me nivelin më të ulët të arsimit dhe kanë mungesën të aftësive profesionale për

t'u integruar në tregun e punës. Niveli i ulët arsimor bëhet pengesë që ata të regjistrohen në shkollat e arsimit profesional. Përmes arsimit bazë të pjes'shëm atyre mund t'u jepet mundësia për të përfunduar arsimin e detyrueshëm për t'u regjistruar më pas në arsimin e mesëm profesional dhe më tej. Kjo mungesë e parashikuar nga aktet ligjore në fuqi nuk iu ofrohej fëmijëve të komunitetit rom në shkollën 9-vjeçare "Agimi", Maliq. Gjatë procedurës së shqyrtimit të çështjet institucionet përgjegjëse morën masat përkatëse për hapjen e klasave të arsimit bazë me kohë të pjes'shme në shkollën 9-vjeçare "Agimi" Maliq për vitin shkollor 2020-2021, duke zgjidhur kështu problematikën e adresuar pranë Komisionerit.

Problematika e segregimit të fëmijëve që i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane në shkolla të caktuara vijon. Komisioneri ka konstatuar diskriminimin në formën e segregimit, nga ana e DAR Shkodër, për shkak të "racës", së nxënësve romë dhe egjiptiane, që mësonin në Shkollën 9-vjeçare "Liria" Shkodër dhe Shkollën vartëse "Isuf Tabaku", Ajasem, Shkodër dhe urdhëroi marrjen e masave të menjëhershme për rregullimin e situatës dhe parandalimin e situatave të tilla në të ardhmen.

#### • **Punësimi dhe Formimi Profesional**

Në vitin 2020, largimi nga puna, nga punëdhënësi institucion publik, me motiv diskriminues është konstatuar nga Komisioneri, për një grua që i përkiste pakicës rome.

Gjithashtu, nga ankesat e shqyrtuara është evidentuar një mungesë procedure standarte ligjore për konstatimin, bllokimin dhe shoqërimin e mjeteve dhe mbetjeve të riciklueshme të anëtarëve të pakicave rom dhe egjiptian.

#### • **Mbrojtja Sociale**

Problematika e furnizimit me energji elektrike për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane, të cilët për shkak të gjendjes ekonomike e kanë të pamundur që të paguajnë në avancë shumën lekësh, për lidhjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, detyrim ky i përcaktuar në rregulloren e miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE). Komisioneri urdhëroi ERE të marrë masa për ndryshimin e Rregullores duke çliruar nga barra e pagesës së tarifës së lidhjes së re, aplikantët që trajtohen me statusin e "klientit në nevojë", të cilët ndodhen në pamundësi financiare.

Problematika e furnizimit me ujë të pijshëm, mungesa e kanalizimeve apo ndriçimit në zona ku pjesa më e madhe e banorëve i përkasin pakicave rome apo egjiptiane është trajtuar në disa raste nga Komisioneri në qytete të ndryshme si Elbasan, Shkodër, Fier dhe Korçë. Komisioneri ka konstatuar diskriminimin e këtyre banorëve dhe ka urdhëruar Bashkitë respektive dhe shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve që të marrin masa për rregullimin e situatës. Në rastin e banorëve në Shkodër dhe Korçë, autoritetet kanë zbatuar vendimet e Komisionerit duke zgjidhur problematikat e konstatuara.

- **Antixhipsismi**

Nisur nga rastet e trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjuha e përdorur në media, median sociale kundër pakicave rome, egjiptiane, nga gazetare, persona publike madje edhe deputetë, janë konsideruar nga Komisioneri si diskriminim ndaj këtyre grupeve dhe janë dhënë vendimet përkatëse.

Një tjetër evidentim i Komisionerit është problematika e përdorimit të terminologjisë së papërshtatshme për etiketimin e zonave të caktuara të cilët banojnë nga anëtarë të pakicave rome ose egjiptiane, ku në dokumentacion zyrtar të përdorur nga ofruesi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike në qytetin e Shkodrës, i cili referon në faturën tatimore lagjen “Iliria” si “Lagja e Magjypëve”. Gjatë shqyrtimit të çështjes nga Komisioneri operatori i furnizimit me energji elektrike në qytetin e Shkodrës mori masa të menjëhershme për heqjen e termit “Lagja e Magjypëve” nga fatura tatimore, duke zgjidhur kështu problematikën.

❖ **Lidhur me Draft Matricën PKVBPPRE 2021-2025 kemi disa propozime për aktivitete lidhur me objektivat:**

Në fushën: “**Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrimin civil**”, objektivi nr. 1 “*Ofrimi i ndihmës ligjore për pasqyrimin e të dhënave reale në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të Minoritetit Romë dhe Egjiptian me qëllim zgjidhjen e problematikave që i pengojnë në aksesin e tyre të plotë në shërbimin e gjendjes civile*”, pika 1.11 “*Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të gjendjes civile për: çështjet e barazisë dhe mosdiskriminimit, të pashtetësisë dhe të drejtave të njeriut.*”

Rekomandojmë që të shihet mundësia që edhe Komisioneri të jetë pjesë e institucioneve mbështetëse, për pjesën e ofrimit të trajnimeve të kapaciteteve të punonjësve të gjendjes civile, për fushën e diskriminimit.

Ndërsa sa i takon problematikës së “pashtetësisë”, që trajtohet gjerësisht edhe në Draft-in e PKV-së<sup>1</sup>, konkludojmë se është një pengesë për pakicat rome dhe egjiptiane për akses të barabartë në drejtësi. Duhet patur parasysh fakti që personat “*pa shtetësi*”, nuk trajtohen në mënyrë të barabartë kur bëhet fjalë për akses në organet gjyqësore.

Në parashikimet e Kodit Penal, neni 8, thuhet se: “*Për personin pa shtetësi që kryen veprë penale në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe krim jashtë këtij territori, vlejnë rregullat e neneve 7 e 7/a të këtij Kodi.*” Pra, një individ nga komuniteti rom dhe egjiptian i paregjistruar në regjistrin civil shqiptar konsiderohet pa shtetësi, megjithatë mban përgjegjësi penale para organeve të drejtësisë. Ndërkohë nga ana tjetër, të njëjtit individ i kufizohet e

---

<sup>1</sup> Shiko faqe 17 e vijues të Draft-it të PKV-së.

drejta për akses në organet e drejtësisë, qoftë përmes ngritjes së një kërkesëpadie apo kërkesë tjetër, për shkak sepse i kërkojnë të dhëna identifikuese.

Në lidhje me këtë, vlerësojmë se duhet të merren masa që në raste konkrete të tilla, këtyre individëve të mos i'u kufizohet kjo e drejtë, të shihet mundësia e fuqizimit të Qendrave të Ndihmës Ligjore Falas apo të ngrihen struktura të reja ndihmëse që të mund të asistojnë këta individë.

Përsa më sipër, theksojmë se regjistrimi i komunitetit rom dhe egjiptian duhet të përbëjë prioritet në këtë fushë, sepse vetëm në përmbushje të këtij objekti, mund të monitorohen dhe përmirësohen shërbimet e tjera.

Lidhur me Objektivin 2: *“Garantimi i shërbimeve të Ndihmës Juridike Falas për romët dhe egjiptianët”*, propozojmë të shtohet një aktivitet lidhur me miratimin e akteve nënligjore për Ligjin nr. 111/2017 *“Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”*. Janë miratuar dhjetë akte, edhe ato në tejkallim të afateve ligjore (10 akte). Dy prej tyre, të cilat nuk janë miratuar ende, janë përgjegjësi e Ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.

Kështu propozojmë të shtohet si aktivitet:

- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për Ligjin nr. 111/2017 *“Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”* në bashkëpunim me MD dhe DHKA.

Në fushën **“Strehimi”**, objektivi nr.1, aktiviteti nr. 1.1 *“Zbatimi i programit të subvencionimit të qirasë në njësitë e qeverisjes vendore për minoritetin rom dhe egjiptian”*, sjellim në vëmendje se nga ana e njësisve vendore duhet të merren masa edhe për gjetjen e banesave me qira (kur është e domosdoshme), pasi shpesh herë hasen me diskriminimin për të marr një banesë me qira për shkak të races dhe etnisë.

Sa i takon përfshirjes së rekomandimeve të ECRI-t<sup>2</sup>, tek objektivi Nr. 1, treguesi 1.3 *“Rritja e numrit të përfituesve romë dhe egjiptianë nga çdo program strehimi”*,

në pikën 1.3 *“Përmirësimi i kushteve të strehimit të romëve dhe egjiptianëve, përmes granteve konkurruese për bashkitë”*, rekomandojmë që të përfshihet apo të mbahet parasysh në veçanti, si çështje parësore, gjetja e një zgjidhje të shpejtë për krizat afatgjata të strehimit që prekin komunitetet romë dhe egjiptiane në zonat e Kabashit dhe të Gurit të Kuq të Bashkisë Pogradec.

Në të njëjtën fushë, në të njëjtin objektiv, rekomandojmë që të merret në konsideratë shtimi i një treguesi ku të mbahet parasysh edhe një tjetër rekomandim i bërë nga ECRI, i cili citon se autoritetet të sigurojnë që të gjithë romët dhe egjiptianët, si dhe çdo person tjetër, të cilët

---

<sup>2</sup> Referuar Raportit të ECRI-t për Shqipërinë, (cikli i gjashtë monitorues), miratuar në 07.04.2020.

mund të dëbohen nga shtëpitë e tyre, të gëzojnë të gjitha garancitë që parashikojnë tekstet ndërkombëtare në lidhje me këtë.

Në fushën **“Kujdesi shëndetësor”**, Objektivi 1: Përmirësimi i shëndetit të romëve dhe egjiptianëve përmes rritjes së aksesit të tyre në shërbime cilësore shëndetësore dhe atyre parandaluese, aktiviteti *“1.2 Kryerja e studimit në lidhje me largësinë e vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane nga qendrat shëndetësore si dhe nevojat për ngritjen e pikave të reja shëndetësore pranë vendbanimeve rome dhe egjiptiane”*, lidhur me këtë aktivitet nuk është përcaktuar institucion përgjegjës.

Në fushën **“Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor”**, Objektivi 2: *“Përkrhja e një sistemi gjithëpërfshirës të arsimit, duke mundësuar qasje të barabartë në arsim cilësor për romët dhe egjiptianët”* tek objektivi 2: *“Përkrhja e një sistemi gjithëpërfshirës të arsimit, duke mundësuar qasje të barabartë në arsim cilësor për romët dhe egjiptianët”*, aktiviteti 2.2 *“Trajnim dhe kualifikim i stafit të institucioneve arsimore parashkollore dhe parauniversitar për: Arsimin gjithëpërfshirës në kuadrin e diversitetit social & kulturor, dhe antixhopsizmit”*.

Propozojmë të shikohet mundësia e përfshirjes edhe të institucionit të KMD, si institucion përgjegjës për trajnimin e stafit të institucioneve arsimore lidhur me çështjet anti-diskriminim.

Në fushën **“Punësimi dhe aftësimi”**, Objektivi 1: *“Nxitja e punësimit të romëve dhe egjiptianëve nëpërmjet AFP-së, dhe PATP-ve”*. Propozojmë të shtohen dy aktivitete në vijim të aktiviteteve të parashikuara tek objektivi 1 si më poshtë:

*–“Mundësimi i punësimit të artizanëve nga pakicat rom dhe egjiptian” dhe “Përfshirja e degëve në arsimin profesional që lidhen dhe traditën dhe kulturën e romeve dhe egjiptianeve”*.

Në fushën e **“Punësimit dhe aftësimit”**, Objektivi Nr. 2 *“Nxitja e sipërmarrjes (sociale) dhe vetëpunësimit të romëve dhe egjiptianëve”*, pika 2.7 *“Formalizimi i aktivitetit të grumbulluesëve individualë romë dhe egjiptianë të mbetjeve të riciklueshme dhe përcaktimi i masave për integrimin e tyre gradual në sektorë të tjerë punësimi”*, rezulton të jetë një tregues i përsëritur nga Plani i mëparshëm i Veprimit 2016-2020. Nuk është e qartë sesi është bërë monitorimi i këtij treguesi edhe pse ky tregues nuk e ka arritur objektivin e tij, megjithatë mbetet për t’u vlerësuar fakti që në aktivitetet e parashikuara për këtë tregues, në këtë Plan të ri Veprimi, janë përfshirë edhe rekomandimet që KMD ka dhënë nëpërmjet vendim-marrjes së tij, gjatë shqyrtimit të ankesave<sup>3</sup>, për kryerjen e një studimi mbi situatën dhe pozicionin e grumbulluesve individualë romë dhe egjiptianë të mbetjeve të riciklueshme

<sup>3</sup> Referuar Ankesës Nr. 17, datë 05.03.2020, në sajë të së cilës KMD ka dalë me Vendimin Nr. 133, datë 08.10.2020, duke konstatuar diskriminim të tërthortë për shkak të “racës”. Gjatë shqyrtimit të këtij rasti, u konstatua se ka patur edhe raste të tjera ku reflektohet e njëjta problematikë.

në Republikën e Shqipërisë. Përveç kësaj duhet të merret në konsideratë edhe propozimi për zgjidhje të kësaj problematike duke përcaktuar edhe institucionet që duhet të bashkëpunojnë, duke mos përfshirë vetëm Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Në fushën **“Mbrojtja sociale”**, Objektivi 1: *“Përfshirja e Romëve dhe Egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale”*, nisur nga praktika e KMD-së ku disa familjeve rome dhe egjiptiane i është mohuar njohja e statusit të *“Klientit në nevojë”* dhe nuk i është bërë e mundur lidhja e energjisë elektrike, për shkak të pamundësisë për të paguar tarifën e lidhjes së re, propozojmë të shtohet një aktivitet në vijim të objektivit nr.1:

*-“Ndryshimi i Rregullores së Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, duke çliruar nga barra e pagesës së tarifës së lidhjes së re, aplikantët që trajtohen me statusin e “klientit në nevojë”, të cilët ndodhen në pamundësi financiare”.*

*-Miratimi i VKM “Për hartimin e kriterëve dhe procedurave për përfitim të sttausit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre”, ky duhet të jetë aktivitet prioritar për t’u realizuar, brenda vitit 2022.*

Në fushën: **“Antixhipsizmi”**, theksojmë se nuk është bashkëlidhur varianti mbas kometeteve të Komisionerit dërguar me datë 31 maj 2021 (*të cilin ju na i ri-dërguat të ndyshuar me datë 03.06.2021*). Duke qenë se nuk janë parashikuara në këtë draft final, bashkëlidhur këtij dokumenti gjeni edhe komentet për Matricën Antigjipsism.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**  
  
**ROBERT GAJDA**